



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTËR SHTETI
PËR ÇËSHTJET VENDORE

**Mbledhja e parë e Këshillit Konsultativ të Qeverisjes
Qendrore e Vetëqeverisjes Vendore**

2017-02-16 10:04:00



Këshilli Konsultativ i Qeverisjes Qendrore dhe Vetëqeverisjes Vendore, i ngritur në janar të këtij viti zhvilloi sot mbledhjen e tij të parë. Këshilli Konsultativ i cili bashkëdrejtohet nga Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, z.Bledi Çuçi dhe Kryetari i Bashkisë së Tiranës në cilësinë e tij si Kryetar i Shoqatës për Autonomi Vendore, z.Erion Veliaj diskutoi gjerësisht mbi projektligjin e ri për Financat Vendore, që përbën një nga ligjet më të rëndësishme për funksionimin dhe vazhdimësinë e reformës administrative-territoriale.

Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, z.Bledi Çuçi ndërsa vlerësoi rolin e Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore dhe Vetëqeverisjes Vendore si një instrument kyç në dialogun me qeverisjen vendore, nënvizoi se ligji i ri për financat vendore do të reflektojë të gjitha propozimet dhe sugjerimet e Bashkive .

“Pa diskutim që ka vërejtje, prandaj është tryeza e dialogut, ata kanë këndvështrimin e tyre, qeveria ka detyrimin e saj në lidhje me gjithë sistemin makro-ekonomik dhe të gjitha këto pikëpamje hidhen në tavolinë, diskutohen, ezaurohen, marrin qendrimit përkatëse dhe në fund miratohen. E rëndësishme është që çdo gjë që ka secili nga aktorët pjesëtarë, qoftë të qeverisjes qendrore, qoftë të qeverisjes vendore të diskutohet në një dialog konstruktiv dhe kjo tryezë, Këshilli Konsultativ e mundëson më së miri këtë gjë”, u shpreh Ministri Çuçi.

Z.Çuçi u shpreh gjithashtu se ligji i ri për financat vendore pritet të miratohet brenda kësaj legjislatore. “Ligji i ri për financat vendore do i nënshtrohet diskutimeve, do e miratojmë në qeveri, qeveria e dërgon në Parlament dhe shpresojmë që brenda këtij sesiioni Parlamentar ta miratojmë”, u shpreh ai.

Kryetari i Bashkisë së Tiranës njëherësh kryetar i Shoqatës për Autonomi Vendore, z.Erion Veliaj deklaroi se me reformën administrative-territoriale, Bashkitë kanë marrë edhe më shumë kompetenca. Sipas tij, është e rëndësishme tashmë dhe rishikimi i mënyrës së financimit të këtyre njësisve vendore duke pasur një ligj shumë herë më fleksibël. Veliaj tha se tashmë duhet të azhurnohet edhe sistemi i operimit financiar të bashkive. “Sigurisht po hymë në një terren të panjohur, pas reformës territoriale bashkitë janë bërë jashtëzakonisht të mëdha, kanë marrë shumë kompetenca, por është shumë e rëndësishme që bashkë me kompetencat të marri dhe mënyrën sesi zgjidhen problemet. Ne kemi bërë disa propozime konkrete. Së pari, është shumë e rëndësishme që të konsiderohet pak vlera e grantit. Qeveria aktuale është treguar jashtëzakonisht bujare me bashkitë dhe ka e pasur prioritet këtë reformë, por unë besoj që në afatgjatë nuk mbetet vetëm tek vullneti i qeverisë, por kjo duhet lidhur si 1% e produktit të brendshëm bruto”, tha Veliaj.

Kreu i Bashkisë e cilësoi si tepër të rëndësishme këtë formulë, që pavarësisht nëse janë të majta apo të djathta, të ofrojnë më shumë shërbime për qytetarët.

Gjatë mbledhjes së parë, Këshilli Konsultativ miratoi edhe

rregulloren e këtij organizmi sikurse diskutoi edhe mbi çështje që lidhen me mjedisin.
Këshilli Konsultativ u ngrit pas një vendimi të Këshillit të Ministrave të miratuar në 21 dhjetor 2016, dhe është gjithashtu një zbatim i drejtpërdrejtë i Kartës Evropiane për Vetë-Qeverisje Vendore .